



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-090

Prishtinë, më 23 janar 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 JANAR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Burim Ramadani, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14 janar 2013,
2. Vazhdimi i mbledhjes plenare,
3. Përgatitjet për shënimin e 5-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës,
4. Shkresa e Kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij, të katërt, me kryeministrin e Serbisë,
5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel,
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 janar 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 janar 2013.

2. Vazhdimi i mbledhjes plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 21 janar 2013, vendosi që kjo mbledhje plenare e Kuvendit t'i vazhdojë punimet të enjten, më 24 janar 2013, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e organeve,
5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës,
6. Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017,
7. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
8. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

3. Përgatitjet për shënimin e 5-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me përgatitjet për shënimin e 5-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, mori këtë:

V E N D I M

I. Kuvendi, më 17 shkurt 2013, në orën 15:00, do të mbajë një seancë solemne për shënimin e 5-vjetorit të Pavarësisë të Republikës së Kosovës.

II. Me rastin e shënimit të 5-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Administrata e Kuvendit ngarkohet që t'i publikojë dokumentet, si në vijim:

1. Publikimi i dokumenteve lidhur me ngjarjet më të rëndësishme prej 17 shkurtit 2008 deri më 17 shkurt 2013; Deklarata për shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës; Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës; amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës dhe të rezolutave,
2. Publikimi i librit “Kosova, 5 vjet shtet”,
3. Publikimi i tekstit të Kushtetutës me amendamentet e miratuara (1-22),
4. Furnizimi me materiale reprezentative,
5. Rregullimi i ambienteve për shënimin e këtij përvjetori.

III. Shpenzimet për aktivitetet e parapara në pikën 2 të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Pikatë shtesë:

4. Shkresa e Kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij, të katërt, me kryeministrin e Serbisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Kryeministrit të Kosovës për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tij, të katërt, me kryeministrin e Serbisë, vendosi që kjo çështje të radhitet në rend dite për mbledhjen plenare të radhës.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, e mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i kryetarit të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, për të marrë pjesë në Konferencën e tretë vjetore për shtetet e Ballkanit Perëndimor në Parlamentin Evropian, e cila do të mbahet prej datës 28-30 janar 2013, në Bruksel.
2. Shpenzimet e udhëtimit i bart organizatori, ndërsa shpenzimet e akomodimit dhe mëditjet shtesë për të lartshënuarin në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Të ndryshme:

6. Propozimi për formimin e grupeve të miqësisë

Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit lidhur me përgatitjen e për formimin e grupeve të miqësisë.

Kryesia konkludoi që propozimi për formimin e grupeve të miqësisë t'u shpërndahet anëtarëve të Kryesisë dhe kryetarëve të grupeve parlamentare të Kuvendit dhe pastaj në mbledhjen e radhës të Kryesisë të vendoset për formimin e tyre.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale